

REXHEP QOSJA REZISTENCA KULTURORE DHE NDËRTIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR PËRMES KRITIKËS LETRARE DHE HISTORIOGRAFISË

Emine SHABANI

Universiteti i Tetovës Fakulteti i Filologjisë-Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
emine.shabani@unite.edu.mk

Abstrakt

Rexhep Qosja qëndron si një nga figurat më të shquara në letërsinë dhe kritikën letrare shqipe, vepra shumëplanëshe e të cilit përfshin prozën, teorinë letrare dhe mendimin politik. Kontributet e tij dallohen nga një angazhim i thellë me dilemat historike, kulturore dhe ekzistenciale të popullit shqiptar, veçanërisht brenda kontekstit të socializmit jugosllav dhe transformimit postkomunist. Si romancier, Rexhep Qosja është i njohur për strukturat e tij komplekse narrative, thellësinë filozofike dhe pasurinë simbolike të dukshme, në vepra të tilla si *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, e cila ndërthur dashurinë, identitetin kombëtar dhe kritikën ideologjike. Në sferën e kritikës letrare, shkrimet e tij sfidojnë interpretimet tradicionale, duke mbrojtur një letërsi kombëtare që pasqyron realitetet shoqërore në zhvillim dhe autonominë intelektuale të kulturës shqiptare. Për më tepër, esetë politike dhe ndërhyrjet publike të Qosjes e forcojnë më tej rolin e tij si një zë kritik në formësimin e vetëdijes kombëtare shqiptare. Ky abstrakt shqyrton gamën tematike dhe stilistike të veprës së Qosjes, duke theksuar ndikimin e tij në letrat shqipe dhe rëndësinë e tij të qëndrueshme në Ballkanin post-totalitar.

Fjalët kyçe: rezistenca kulturore, identiteti kombëtar, kritika letrare, historiografia.

Abstract

Rexhep Qosja stands as one of the most prominent figures in Albanian literature and literary criticism, whose multifaceted work encompasses prose, literary theory, and political thought. His contributions are distinguished by a deep engagement with the historical, cultural, and existential dilemmas of the Albanian people, particularly within the context of Yugoslav socialism and post-communist transformation. As a novelist, Rexhep Qosja is known for his complex narrative structures, philosophical depth, and apparent symbolic richness, in works such as *Death Comes to Me Through Such Eyes*, which interweaves love, national identity, and ideological critique. In the realm of literary criticism, his writings challenge traditional interpretations, advocating for a national literature that reflects evolving social realities and the intellectual autonomy of Albanian culture. Furthermore, Qosja's political essays and public interventions, further strengthen his role as a critical voice in shaping Albanian national consciousness. This abstract examines the thematic and stylistic range of Qosje's work, emphasizing his influence on Albanian literature and his enduring importance in the post-totalitarian Balkans.

Keywords: cultural resistance, national identity, literary criticism, historiography.

Hyrje

Ashtu siç kishim në ditët më të vështira të kombit, kolos të letrave, që përpos letërsisë artistike, studimeve kritike e publicistike, ata u morën edhe me, histori, prozë, dramaturgj, përkthime, ishin edhe deputetë, në parlamentin e Mbretërisë shqiptare, lëvrues të gjuhës, hartues të alfabetit, mbledhës të folklorit, e që njohën për së afërmi vuajtjet e popullit të gjitha këto vepra i bënë të pavdekshëm emrat e mëdhenj, që nga Buzuku, Budi, Bogdani: De Rada, Naimi, Samiu, Kristoforidhi, Pashko Vasa, Fishta, Noli, Migjeni etj.

Do të mjaftonte të veçonim disa dëshmi nga puna rreth 60 vjeçare, e Rexhep Qosjes, në shërbim të kulturës dhe kombit, për tu kujtuar gjithmonë emri i tij.

1. Studimet shteruese mbi autorët e Rilindjes Kombëtare në tre vëllime, Porosia e madhe, Dialogë me shkrimtarët. Rexhep Qosja kishte njoftuar në shkrimet paraprake se do ti vazhdojë deri në letërsinë bashkëkohore, studimet për letërsinë shqipe, por për shkak të rrethanave politike të viteve 90-ta, e ndryshoi kahjen e shkrimeve, në ato publicistike politike, politologjike, kulturologjike, memoaristike polemizuese, dhe me karakter historik-njohës, që ndër të tjera ishin: *Fati i pambrojtur*, *Kritikë letrare*, *Kontinuitete*, *Nocione të reja albanologjike*, *Anatomia e kulturës*, *Sprova kulturologjike*, *Demokracia e shpërdorur*, *Morfologjia e një fushate*, *Shpërngulja e shqiptarëve sipas programeve kombëtare serbe*, *Epizode letrare*. Për veprën Dialogje me shkrimtarët, Goldstein vlerëson se janë diskutime, ndërsa për Shkrimtarë dhe periudha dhe Nga tipologjia deri te periodizimi, janë pjesërisht diskutime.

2. Romanet *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, *Bijtë e askujt*, Të fshehtat e treguara, *Një dashuri dhe shtatë faje* dhe dramat: Beselem pse më flijojnë, Sfinga e gjallë etj.

3. Pjesëmarrjen aktive në shoqërinë e hapur: mëkëmbja e komunikimit ndëreshqiptar, faktorizimi i shqiptarëve në Kosovë, themelues i një partie politike në Kosovë, përfaqësues i popullit të vet në Rambuje, etj. Ky ndryshim nga letërsia artistike në veprimtari publicistike politike, ishte rrjedhojë e ndryshimeve të rrethanave në të gjitha hapësirat shqiptare e më gjerë, që e rendisin Rexhep Qosjen në yllësinë e shkrimtarëve, poetëve, të letërsisë shqipe, ballkanike, evropiane e më gjerë.

Ndërsa vepra letrare e autorit përbën pasuri ideore e tematike, larmi të zhanrit në krijimet prozaike e dramatike.

Romanet-vepra letrare

Vetëm autorët e mëdhenj, mund të hynë në sfera tmerrësisht të thella të shpirtit njerëzor. Ato janë motive shumë të thella, ku e gjithë kultura pulson në frymë të njëjtë. Vepra letrare e R. Qosjes, ka karakter postmodernist, si për intertekstin, metateksin, metagjuhën, format narrative origjinale, (kapituj me dialogë, të kombinuar me kapituj prozaik, të paraprirë me fjalë të urta të njerëzve të artit e shkencës, që janë plotësisht në rrjedhë me rrëfimet e autorit, te: (Të fshehtat e treguara, *Bijtë e askujt*, *Një dashuri dhe shtatë faje*.)

Me stilin dhe narracionin që përdor në romane, e drama, arriti të ndërrojë hierarki, të sistemit kombëtar, në sistemin rajonal, e europian, pasi që vepra e tij është përkthyer në disa gjuhë.

Letërsia krijon modele, simbole, skema sjelljesh, arketipe dhe lloje kodesh të civilizimit që mund të identifikohen vetëm me popullin që i përkasin. Ky fakt është i shpërndarë në tërë veprën e Rexhep Qosjes. Në këtë botë prozaike autori ka gërshetuar diversitetet të tematikave, karaktereve, individit dhe shoqërisë, etniteteve, fiseve, popujve, luftërave, heroizmave, si dhe gërshetimin e antikes me modernen, për të treguar kontinuitet, të Dardanisë së lashtë me shqiptarët e sotëm. Në veprën letrare dhe atë publicistike-kulturologjike, ai shpalos filozofinë etike në një realitet shoqëror të kohës më të re, veçoritë e analizës psikologjike të karaktereve, elementet ekzistencialiste në tiparet e heronjve antik, si mbrojtës të identitetit fisnor dhe integritetit gjeografik.

Dobësia nuk ekziston në shpirtrat që janë të ndarë nga materialja. Në art dhe në konceptin e tij nuk ka gabime. Arti nuk imiton atë që shihet, por ai ngrihet në nocion.

Talenti është nocioni i materies, ndërsa shpirti është materia e tyre, thotë filozofi antik Plotini (110). Vepra letrare e Rexhep Qosjes, shpërfaq realitetin e kompresuar në figura të zgjedhura e të goditura, metafora, alegori, parabola, ironi, satirë, e parodi.

Interteksti në veprat e autorit, përfshin një këndvështrim, që përmban në vete kombinime të artit me faktografinë, historiografinë, folklorin, mitin, antropologjinë, legjendat etj.

Proza e Rexhep Qosjes përmban foljet prozaïke, të ndërfutura në domenin e mendimit të tij filozofik, të cilat shpërfaqin dëshirat, vuajtjet, meditimet, dhimbjet, ankthin qoshin ato personale, njerëzore apo mbarëkombëtare. Siç i kemi te Vdekja më vjen prej syve të tillë, Një dashuri dhe shtatë faje, Bijt e askujt, Të fshehtat e treguara, Nata është dita jonë, etj.

Në romanin Të fshehtat e treguara autori, në fillim përmend veprën Varreza e Pragës të Umberto Ekos. Romani fillon me një ëndërr të narratorit, që bashkëndjen me autorin e Varrezës së Pragës, për sikletin që kishte pasur para se ta shkruante këtë roman të madh. Në të dy veprat, ka fije paralele për *simoninët*, që përmend Eko në romanin e tij. Si epiqendër të veprës së Ekos kemi urrejtjen dhe nxitjen e vazhdueshme për urrejtje.

Anima e narratorit, që bashkëbisedon në këto momente, e shtyn të shkruajë, pavarësisht sikletit, krupës, që ndjen: “Ke vendosur të shkruash për Një siklet të madh shpirtëror dhe për Do siklete shoqërore, prandaj nuk e di pse ke harruar se më mirë shkruhet kur ke siklet, sesa kur je i gëzuar” (Qosja, 2020:12)

Vepra ka në epiqendër dy rrëfimet, rrëfimtarin dhe dy protagonistët, të cilët do të kujtohen, ashtu siç ka ndodhur gjithmonë, autorët kanë mbetur të pavdekshëm, ndërsa udhëheqësit, janë harruar.

Nëse nuk e merrni jetën me humor, ju jeni i humbur, kriminelët dhe armiqtë e mëdhenj të njerëzimit, siç janë një grup prej tyre e sidomos Hitleri që e ka marrë shumë seriozisht veten pa asnjë nuancë humori, thotë me ironi semiologu Eko, për romanin Varreza e Pragës. Prandaj mes tragjedisë dhe katastrofës së madhe, dua të them se ne të gjithë do të vdesim, gjithçka do të jetë e shkurtër në fund megjithatë ne i kemi këto aspirata kaq të thella, të pafundme, por humori është gjithashtu një ilaç kundër urrejtjes në roman. Varret janë përmendur shpesh edhe te *Të fshehtat e treguara*, si varret te Shkëmbi i Kalasë, në fillim të romanit, varret antike të zbuluara në Dardaninë e lashtë, gjithsej 39, një varr me tre njerëz dhe, një varrezë me trembëdhjetë njerëz të varrosur vertikalisht dhe, kjo u kishte nxjerrë punë arkeologëve.

Urrejtja është një ndjenjë e çuditshme në fund të romanit të Ekos, Ratkovski shefi i policisë teiste fal urrejtjeje me bollëk, urrejtja është bujare, e ngrohtë mban bashkë një popull të tërë kundër të tjerëve, prandaj përdoret kaq shpesh nga udhëheqësit, thotë Eko. Ndërsa dashuria është jashtëzakonisht përzgjedhëse, ajo i kufizon marrëdhëniet njerëzore. Narcistët, ashtu si djaloshi mitik Narcisi, përveç që injorojnë e nënçmojnë të tjerët, ata nuk e duan as veten. Ky djalosh duke parë veten në pasqyrën e liqenit, dashurohet në pamjen e tij dhe tretet, pasi që nuk mund ta arrijë atë që e sheh dhe mbytet në liqen.

Prandaj zbërthimi i mitit të Narcisit, është aktual edhe sot, ndoshta do të jetë gjithmonë, bërthama mitike e së cilit, flet se urrejtja ndaj të tjerëve, është projeksion i urrejtjes ndaj vetes në rend të parë, ai në fakt nuk e do veten, është i privuar nga dashuria. Rrëfimi për Narcisin është një parodi e dashurisë, një formë perverse/ekstreme e saj. Në tempullin e Delfit shkruhej “Njih vetveten”, ndërsa kur e pyetën orakullin Tireseu prindët e Narcisit a do këtë jetë të gjatë djali i tyre, ai u tha : “Nqs, nuk do ta njohë veten, ai do jetojë, gjatë”. Ai nuk e njeh veten, ajo dashuri që ka ndaj vetes, nuk është rruga kah vetja. Rrëfimi mbi Narcisin është rrëfim metaforik, simbolik dhe si i tillë mitik.

Dashuria ndaj vetes është thelbi i ekzistencës së njeriut, është vetrespekt. Kjo është dashuri që ushqen, frymëzon, që çon në përparim, individin, kolektivin, popullin.

Narcisi nuk arriti ta njohë veten, rruga deri te vetja është rruga nëpërmjet tjetrit. Është paradoksale fjala e Tireseut, sepse ai njohu vetëm pamjen e jashtme por jo edhe brendinë e zbrazët të tij. Romanet dhe dramat e Rexhep Qosjes janë të mbushura me narcistë, që urrejnë, fshikullojnë, përgjojnë, terrorizojnë, burgosin.

Vepër që rrëfen interferencë ndërkulturore dhe jo e vetmja, ndër më përfaqësueset e autorit, romani *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, është një ndër më të suksesshmet në letërsisë bashkëkohore shqipe në përgjithësi. Roman i veçantë për stilin, gjuhën, ndërtimin, filozofinë, analizën psikologjike dhe tematikën. Fatin tragjik të shqiptarëve autori e shtjellon përmes

rrëfimeve nga e kaluara dhe e tashmja, përpjekjet e tyre për të mbijetuar dhe për të qenë të barabartë, në vatrat mijëra vjeçare të paraardhësve të tyre, me gjithë robërinë 500 vjeçare dhe rimëkëmbjen e penguar nga fqinjët.

Sytë kanë qenë element simbolik e metaforik, nga shumë autorë, tjerë në poezitë e prozën e tyre: Si Umberto Eko, Çezare Pavese, madje ekzistojnë 32 vepra të njohura, në botë që kanë si titull ose lajtmotiv, sytë: Sytë postkolonial, Bota nëpërmjet syve të engjëjve, Bora nga syri i thyer, etj.

“Dhe ata sy, oh ata sy. . . Rrotullohen me ethe, bebëzat e tyre me ngjyrën e bukës së thekur, që pasqyrojnë një mëlçi të sëmurë, të korruptuar nga sekrecionet e prodhuara nga urrejtja tetëmbëdhjetë shekullore, të përshtatur nga një mijë rrudha të vogla që thellohen me kalimin e moshës, dhe tashmë në moshën njëzet vjeç, hebreu duket i tkurrur si një njeri plak”. (Eko:15-16)

Titulli shpesh përmban çelësin e deshifrimit të tekstit, Leo Spitzer titullin e përcakton si: “*kategori imperative të personazhit*”, për çdo rrëfim ashtu edhe për çdo personazh historik dhe jo historik. Në vitin 1951, edhe Cesare Pavese shkrimtari italian, shkroi poezinë, për sytë e tmerrshëm të gardianëve të burgut.

Në një sistem distopik, një numër i caktuar shkrimtarësh kanë shprehur revoltën e tyre nëpërmjet artit letrar, si: Bulgakhovi, Xhems Xhojsi, Orwelli, Folkneri, Kundera, Prusti, ndër shqiptarët është Rexhep Qosja, Xh. Spahiu, V. Zhiti, P. Marko, Kadare, etj. Kjo revoltë është shprehur duke kritikuar, ironizuar dhe satirizuar personazhet, që përfaqësojnë agresorin, Danjollin dhe shërbetorët e tij. Satira sardonike është veti e shkrimtarëve të mëdhenj. Protagonistët e romaneve me ironi, parodi, e përqeshje e mundin dhe mbizotërojnë frikën, dhunën, survejimin.

Revolta historike dhe satirizimi i agjentëve politik gjatë dialogimit të personazheve, përbën një risi në trajtimin e temës dhe subjektit, të romanit bashkëkohor shqiptar. Ky roman që autori e quan me modesti, trembëdhjetë tregime që mund të quhen roman, me një përmbajtje të thellë distopike, fshikullon veprimet despotike dhe autoritare të udhëheqësve, abuzimin me masën, duke hyrë në sferat më intime të jetës së tyre dhe duke e dehumanizuar njeriun nga të gjitha atributet e të qenurit si i tillë. Ky dehumanizim ku gërshetohet atmosfera kafkiane dhe shpërfaqja demonike si te Fausti e Mjeshtri i Bulgakhovit, ku mishërohet Mefistofeli dhe Wolandi prapa figurës së Danjollit të Sherkës, rrëfen mënyrën si përgjohen, ndiqen dhe terrorizohen qytetarët e Vajazanit.

Shtresimet e veprës, shqiptarët dhe etnitetet tjera që bashkëjetojnë në të njëjtën hapësirë gjeografike. “Popujt nuk mund ti zgjedhin fqinjët, as prurjet apo ndikimet. Por mund të zgjedhin të jetojnë mes tyre, në marrëdhënie protagonizmi apo antagonizmi. Kultura tradicionale shqiptare, provon se antagonizmi, edhe kur shfaqet në historinë politike, nuk ka qenë një zgjedhje e shqiptarëve, por një imponim i historisë, që e përjashton antagonizmin e qytetërimeve,” (Sinani 137)

Shqiptarët e Vajazanit janë paradigma ekzistencialiste e popullit të varfër pas luftës së dytë botërore. Grotesku, sarkazma, ironia, mënyra e ndërtimit të personazheve dhe situatave të përshkuara shpeshherë paraqesin një fije të hollë satirizimi e dhimbjeje, që lexuesin e çojnë në katarsë dhe empati. *Situata shqyrtohet nga normat e një lirie më të madhe thotë Northrop Frye.*

¹ Në *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, liria është dhunuar plotësisht madje tendencat e postkolonialistëve janë për zhdukjen e tërësishme të konceptit liri, nga truri i pjesëtarëve me identitet të ndryshëm etnik e kulturor, që nuk i llogarisin si qenie njerëzore. Goldmani thotë “*gjenium e vërtetë e karakterizojnë :fakti se duke folur për vetveten ai flet gjithashtu edhe për botën e historinë dhe anasjelltas*”.² Narratori i cili flet në vetën e parë dhe rrëfen ngjarjet është Xhezahiri i Gjikës, për të cilin autori ka një përgjigje në prolog të veprës: “*Dhe thotë Siriu, i*

¹ Northrop Frye, (1978), *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, f. 324.

² Ann Jefferson&David Robbey, (2004), *Teoria Letrare Moderne*, Albas, Tiranë-Tetovë, f. 265.

bir'i Balës:në daçi, Të dini më shumë për Xhezairin e Gjikës, lexojini me kujdes këto rrëfime, Dhe ndaluni e mendoni më gjatë për të, si për veten. ³

Vetëm njeriu që ka ndërtuar qëndrimin dhe identitetin e tij, në gjuhën psikologjike do të përkthehej vetëm ai që e do veten, mund ta njohë tjetrin dhe, ta trasojë rrugën nga toleranca e vërtetë dhe bashkëjetesa. Shkolla mund të të ofrojë edukim që të ndihmon në zhvillim dhe një jetë me diversitete, të cilat të konceptuara drejtë, nuk i ndajnë por i afrojnë dhe pasurojnë njerëzit. Vepra rrëfen për mospërshtatjen, mosbindjen dhe rezistencën e një populli dhe praktikave kulturore të tij pra antagonizmi i imponuar. Gjëja e parë që përvishet të bëjë një neokolonizues është shkatërimi i traditës kulturore të atij populli.

Ata nuk duan t'i përshtaten imponimit kulturor shtypës, invaziv dhe ekspansionist. Në këtë përzierje kulturash, ajo e shumicës ka tendenca ekspansioniste, asimiluese, përbuzëse, shtypëse me fokusin kryesor intelektualët.

Kur forca dominuese është "zmadhuar" suksesshëm në llogari të popujve të nënrenditur e nënshtruar, të cilët gjatë ekspansionit, kanë mbetur kryesisht pasivë dhe të heshtur, në këtë mënyrë analiza e Edward Saidit, merret ekskluzivisht me diskursin e veprimit të kolonizuesit dhe, në mënyrë të pavetëdijshme imiton mosbaraspeshën, e cila është kritikuese. Narratori merret me letërsinë, artistët, krijuesit, aspektet dhe dukuritë historike, kulturore dhe përshkruan jetën shoqërore e atë ekonomike, të grupeve të pafuqishme të cilët mbeten të "të padukshëm", në tekstet postkoloniale, sepse shumica ose merren vetëm me jetën e tyre, ose janë të detyruar t'i ndjekin të tjerët nga grupi i tyre etnik. Tipizimi i figurës së Danjollit përfaqëson tjetrin të ndryshmin nga raca, kultura, religjioni, gjuha. Pra miqtë e Xhezairit janë të paktë që merren me subjektin postkolonial, poeti Antoni, piktori, etj. Termi subaltern, i përdorur nga marksisti italian Gramsci është gjetje e goditur e analizës së popujve të nënshtruar e të mundur, kategoritë e ndryshme të banorëve të marginalizuar, të Vajazanit, që në fakt është përfaqësim dhe tipizim i shqiptarëve jashtë kufijve natyror. Nga tema dhe ideja e veprës mund të nxjerrim edhe përfundimin se narratori tërthorazi pyet: a janë të aftë të nënshtruarit ta përfaqësojnë vetveten, apo janë të gjykuar që gjithmonë dhe në mënyrë të shtrembëruar t'i përfaqësojnë ata të cilët i eksploatojnë! Subalternët, ose prolet siç thotë Orwelli, a mund të flasin? Nga romani gjithashtu shohim se, ata nuk kanë vend ku mund të flasin dhe t'i shtrojnë problemet dhe përvojën e tyre. Ata që tentojnë ti shfaqin, në formë të teksteve letrare ose në mënyra të tjera ngulfaten, terrorizohen, u shkatërrohet familja, i braktisin shokët, shoqëria, etj. Ventrolokuistët ⁴ që i kanë përfaqësuar vetë të drejtat e shqiptarëve para botës, që e dinë se çfarë duan dhe mendojnë, që përflasin për të drejtat e tyre dhe në këtë mënyrë e shuajnë zërin e vetë subjektit subaltern ose të nënshtruar. ⁵

Gjejmë dhe arketipin e Kainit në gjithë veprat e autorit, jo vetëm i huaji por bashkëvendasi i etnisë së njëjtë . Aty ka trimëri, marrëzi, besnikëri e tradhti, urrejtje, konflikte, e kurthe.

Me programe, detyra, e modele lexuesi akademik, integrohet në tekst dhe zbulon ideologjinë, mendësinë, e personazheve që jep efektin e vërtetshmërisë së personazhit. Këtu sipas Bartit kemi një kategori të personazheve deiktikë, që janë parashenja të pjesëmarrjes së autorit në tekst, aty ku Xhezairi përshkruan dhe rrëfen, por ndërmjet rreshtash ndjehet intervenimi i dorës së autorit të cilën e bën më të dallueshëm përfundimi i romanit dhe narracioni i shpërndarë në tërë tekstin.

Dekonstruktimi dhe analiza psikologjike e personazheve narciste, na shpalos filozofinë e kolonizuesit. Sipas Sartre-it koncepti për tjetrin është: *liria jonë varet nga liria e tjetrit dhe liria e tjetrit nga liria jonë*. Nga kjo del se ai sistem që i ka marginalizuar e shtypur popujt, është bazë e mirë për studim të vetë atij sistemi dhe, themelet mbi të cilat ai qëndron. **Arsimimi** nga

³ Rexhep Qosja, (2001), Vdekja më vjen prej syve të tillë, Toena, Tiranë, f. 3.

⁴ Ventroloquist: personi i cili mund të flasë ose t'i shprehë tingujt në atë mënyrë që duket sikur vijnë nga një vend tjetër, ose një argëtues që e bën zërin e tij të duket sikur vjen nga një bedel i një personi apo një kafshe.

⁵ <http://www.thefreedictionary.com/subaltern> Subaltern: A person who is marginalized and oppressed by the dominant culture, especially in a colonial context. b. Such people considered as a group. Njerëz të nivelit inferior.

ana tjetër është kërkesa dhe beteja intelektuale që Xhezairi dhe miqtë e tij e kërkonin me ngulm. (Qosja:2001), Diskursi kolonial ndaj popujve të shtypur, ndërtohet nga binarizimi i kulturave dhe civilizimeve të ndryshme të dy ose më shumë popujve. Këtu na shfaqet vizioni kolonial i botës, prej të cilit del ndasia shoqërore i civilizuar dhe primitiv, që çon në polarizimin e mëtejshëm të botës, racës, kulturës, shenjat kulturologjike, të cilat do ti arsyetojnë përvetësimet, pushtimet dhe diskriminimin e mëtejshëm. Struktura e veprës mund të lexohet horizontalisht, vertikalisht dhe në formë diagonale. Kjo dtth, se ajo ka tre shtresa metanarracionin strukturën horizontale, vertikale dhe transversale. Mënyra e mbrojtjes dhe deklarata e Xhezairit në burg analiza e veprimeve të tij disa ditë para se të burgoset, është një ironi intertekstuale metanarrative. Trajektorja diskursive/vendi i shfaqjes së veprimeve dhe krimeve: Vajazani, që pasqyron hapësirën mbarëshqiptare jashtë kufijve politik të Shqipërisë. Është vepër me kod të dyfishtë, me fokalizim të brendshëm i cili mbulon gjendjen psikologjike të protagonistit dytësor, përvetësimi përmbajtjesor i njërit prej protagonistëve pra Xhezairit, e lë plotësisht në hije Danjollin, i cili është i ndërkryer si hije. Ai në fakt me anë të këtij përshkrimi bëhet lehtë personazh i fshehtë/sekret dhe i papërcaktuar, ashtu siç i quan Proust-i këto tipe personazhesh ‘*’krijesë në ikje’*’. Genette (1996: 107)Përveç titullit sytë janë edhe lajtmotiv në vepër. Vdekja më vjen prej syve të tillë përmendet në faqen 99 kur Danjolli heq maskën dhe, pas saj Xhezairi sheh sytë e kuq të tmerrshëm. Sytë prej të cilëve narratori ndejen neveri:’...bolla që dalin prej syve tu dhe mi vërsulen kërthizës, tigma që duke kërcëllitur dhëmbët më sulmojnë kokën, sorra dhe korba që janë kurdisur në kornizën e fotografisë sime dhe krrokasin, krrokasin, krrokasin, ndjellin zi dhe më shtien tmerrin. Sa shpesh më del përpara syri i Danjollit të Sherkes, i zmadhuar sa një disk i shpuar në mjedis dhe do të mi lexojë mendimet.’’ (Qosja 2010:167) ‘prej syve të tratisur, duke mos ia shkoqur syrin, (155), e heq maskën sytë i qesin gaca. (98), - Oh ti qenke Danjolli! Çfarë sysh! Vdekja më vjen prej syve të tillë! (99), aty ku shihen sytë e çakërritur, shikoje përbindëshin, (157), po mi qite sytë nuk shoh, (265), ta plagos syrin një fotografi e njohur (170, 173, 174,), etj. Janë me dhjetëra fjali, që përshkruajnë ankthin e protagonistit, prej syve të tmerrshëm e të tërbuar.

Përmbajtja e romanit përfaqëson gjendjen e shqiptarëve në rrethana tmerri e ankthi, njerëz që përpiqen të mbijetojnë dhe zhvillohen në rrethana të këtilla, e që përfaqëson një fakt historik. Gjatë mprehjes së konfliktit, shpërfaqen kategoritë estetike të së tmerrshmes dhe tragjikes. Por dallimi ndërmjet këtyre dy kategorive, qëndron te: *Tragjikja ka lejkalim për të ardhmen ndërsa e tmerrshmja është pa rrugëdalje, pa shpresë. Ajo është një shkatërrim i cili në vete nuk bart asgjë iluministe, nuk u premtion njerëzve çlirim nga fatkeqësitë, ky mjerim nuk është i kontrolluar nga njerëzit, nuk është në qeverisjen e tyre, përkundër asaj është mbizotërues i tyre.* (Borev, (2008:118) Qytetarët e Vajazanit janë të rrethuar me forca të verbëta armiqësore. Tmerri i këtyrë e përcakton edhe poetikën e romanit. Marrëzia njerëzore është bërë fakt dhe ka depërtuar në art. Tragjikja në këto rrethana është bërë iracionale dhe është shndërruar në tmer! Narratori në roman na njeh me strukturat e fshehta dhe të errëta të forcës dhe mekanizmit të qeverisjes. Ai shpërfaq demoniumin ose pandemoniumin e qeverisjes. Leximi i teksteve që nxisin ankth, revoltë, dëshprim, me elemente sarkastike, tragjike e të tmerrshme duhet parë në analogji jo vetëm në kohën kur janë krijuar, si kanë ndikuar atëherë, por si ndikojnë sot në jetën tonë dhe çfarë gjurmësh lënë.

Letërsia krijon modele, kode sjelljesh, ruan memorien historike të një populli të një epoke të caktuar, ashtu siç është e përshkruar në roman kjo kohë. Ai përfaqëson edhe frymën e kohës së bujshme dhe vendimtare për shqiptarët. Narratori përveç që rrëfen për shfaqjen e forcës së madhe të qeverisjes, zbulon edhe dobësinë e saj...

Autori përdor shpesh ironinë, satirën sardonike dhe parodizimin në romanet e tij. Kjo mënyrë e rrëfimit dhe përshkrimit të personazheve dhe veprimeve të tyre, është mjeshtëri e shkrimtarëve të mëdhenj, si: Orwellit, Haksllit, Bulgakovit, Xhojsit, Folknerit, Zamjatinit, ‘Ekos, Çezare Paveses. Këtë teknikë përshkruese e gjejmë te Vdekja më vjen prej syve të tillë, Një dashuri e

shtatë faje, (te kapitulli Fjalori i fshehur), Të fshehtat e treguara, në emrat e personazheve: (Mendim Butaku, Qamet Çuka, Garip Gusha, Yllkesha Domi, Zef Jeshili, etj), Bijtë e askujt, (më dendur në kapitullin 23), në aksionet e tyre, te dramet etj.

Përfundimi

Vepra e profesor Rexhep Qosjes, ka një shkallë të lartë të dinjitetit artistik, historik dhe publicistik.

Vlerat, shqetësimet dhe kronologjia e llojllojshmërisë së publicistikës së Rexhep Qosjes, është më e vështirë se të studiohen veprat letrare të tij, sepse bibliografia mbi publicistikën e tij është shumë e kufizuar. Për atë kanë shkruar Kadare në parathënien e romanit Vdekja më vjen prej syve të tillë, e botuar në frëngjisht, Ardian Jasiqi me artikullin Premtime-realizime, Hasan Mekuli me artikullin Simbolika e një realiteti dhe, ky fakt tregon se sa të rëndësishme janë veprat publicistike të Rexhep Qosjes.

Në vitin 1927 shkrimtari francez, me origjinë hebreje, Julien Benda, botoi librin Tradhtia e intelektualëve, në të cilën kritikon intelektualët indiferentë ndaj shtypjes, padrejtësisë dhe luftës. Ndër të tjera ai përmend debatin mes Mikelanxhelos dhe da Vinçit: përderisa Firencja yte po digjet ti merresh me pikturën Darka e fundit. Ai u përgjigj se studimi i së bukurës pushtoi gjithë zemrën e tij dhe ishte i preokupuar se ç'pamje do ti jepte fytyrës së Krishtit, kur do tu drejtohej apostujve të tij se: nesër njëri nga ju do të më tradhtojë. (Benda: 2006). Ç'mund të jetë më e bukur, më fisnike dhe shpirtmadhe se ta mbrosh të vërtetën me punë, shkrime, argumente publicistike-historike, publicistike-politike e politologjike, publicistike memoaristike, polemizuese, kulturore, debate, e pjesëmarrje aktive në konferencat e mbledhjet, për të drejtat e kombit të vet. Profesor Rexhep Qosja e ka dëshmuar këtë me jetën dhe veprën e tij!

Referencat

- [1]. Sinani, Sh. (2015), *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Shtëpia botuese Naimi, Tiranë.
- [2]. Benda, J. (2006), *The treason of the intellectuals* Routledge, Tylor and Francis Group, London and New York.
- [3]. Genette, G. zgjodhi për shtyp Vladimir Biti (1996), *Tipovi fokalizacije i njihova postojanost*, GLOBUS, Zagreb.
- [4]. Qosja, R. (2001), *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Toena, Tiranë.
- [5]. Borev, J. (2008), *Estetika*, Makedonska reč, Skopje.
- [6]. Kant, I. (1978), *Um i sloboda*, Nolit, Beograd.
- [7]. Frye, N. (1978), *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë.
- [8]. Jefferson, A. & Robbey, D. (2004), *Teoria Letrare Moderne*, Albas, Tiranë-Tetovë.